



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME

## Zhvillohet në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme aktiviteti me temë: “Roli i grave shqiptare në shtet-formimin, modernizimin dhe evropianizimin e Shqipërisë”

2018-03-08 15:51:00



Në kuadër 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka organizuar aktivitetin me temë: “Roli i grave shqiptare në shtet-formimin, modernizimin dhe evropianizimin e Shqipërisë”.

Në këtë aktivitet merrnin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, botës akademike, anëtarë të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri, ministra, politikanë, diplomatë, studentë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, etj.

Qëllimi i tij ishte sensibilizimi i shoqërisë mbi të drejtat e grave, forcimi i rolit të tyre dhe barazisë gjinore, i mishëruar në politikat aktuale të qeverisë shqiptare si dhe angazhimi për të përqafuar vlerat evropiane në procesin e anëtarësimit, duke u përgatitur për negociatat.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati foli për rolin vendimtar të grave në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të vendit, duke theksuar domosdoshmërinë e angazhimit të shoqërisë shqiptare për t'i dhënë atyre hapësira më të mëdha në vendin që meritojnë.

Sipas ministrit, “nuk mund t'a mohojmë faktin se debati ynë për shifrat, për përfaqësimin e gruas në jetën publike, ende nuk ka arritur dot të penetrojë tek shtylla kurrizore e shoqërisë.

Më tej në fjalën e tij, ministri theksoi se, “gruaja është shtylla kurrizore e shoqërisë. Ky është një debat që ka të bëjë me Shqipërinë që ne kemi në mendje dhe Shqipërinë që ne dëshirojmë t'i lemë gjeneratave të tjera”.

Ish deputetja Majlinda Bregu u ndal në rolin e grave në shoqëri dhe lidhjen e fortë të tyre me integrimin evropian. “Ne, të gjitha bashkë, nga pozicionet tona, duhet të mundohemi për të sjellë një axhendë të re për gratë dhe vajzat në Shqipëri. Të ulemi dhe të gjejmë ide brilante për mbështetjen e grave në nevojë, viktime të dhunës”.

Në fjalën e saj, ambasadorja e Holandës, znj. Dewi Van De Weerd, duke folur për të drejtat e grave pohoi se në Shqipëri është përballur me një shoqëri të fortë që ka bërë hapa para në përmirësimin e barazisë gjinore. Ajo tha se roli pozitiv i grave është thelbësor në emancipimin e botës tonë dhe se për këtë qëllim ajo ka punuar me aktorë të ndryshëm shqiptarë.

Ambasadorja kroate, Sanja Bujas-Juraga bëri një ekspozitë të barazisë gjinore në Kroaci, duke përmendur ndërmarrjen e hapave konkretë për një shoqëri të vërtetë me të drejta të plota për çdo grua.

Deputetja Eglantina Gjermeni kërkoi fuqizimin e rolit të grave në vendimmarrje, duke bërë të mundur shpalosjen e gjithë potencialit të tyre. Për këtë, tha ajo, shteti dhe qeveria kanë një përgjegjësi shumë të madhe.

Profesoreshë Nevila Nika përcolli mesazhe me vlera historike të grave të shquara shqiptare, bazuar në arkivin shqiptar.

Në fund, pjesëmarrësit u njohën me ekspozitën e hapur në ambientet e MEPJ-së me fotografi të grave shqiptare gjatë historisë

dhe dokumente të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, të Arkivave Qendrore të Shtetit (AQSH), si dhe të Arkivës së MEPJ-së, që flisnin mbi rolin e grave shqiptare në diplomaci.